

The Discovery of *Meshari* three Centuries on

Abstract: *It was in 1741 (or 1743) that Msgr Gjon Nikollë Kazazi, archbishop of Shkup, reported for the first time on the existence of a liturgy book in Albanian dating back to 1555. Then, for almost two centuries, the book fell in oblivion and its traces were lost. But then, in 1909, it was the Arbëresh bishop Pal Skiroi who rediscovered the book, photoed it and prepared a publication. Only excerpts though were published in 1910 in the newspaper Dielli (USA) and then in the newspaper Tomori, in Elbasan and in the Kristo Luarasi's newspaper.*

In 1929, Justin Rrota, o.f.m. decided to travel from Shkodra to Rome in order to photo the Meshari anew and bring copies in Albania. Eventually, he did manage to return with three copies, photoed and bound by the Vatican Library. So for the first time, complete and unabridged copies of the Meshari were available for Albanologists.

Author Osmani mentions among the rest that the origin of the author and the place where Meshari was published raised many doubts over the years. Linguist Eqerem Çabej, for instance, published a critical edition of the Meshari in 1968 where he also expounded his views, maintaining that in all likelihood the origin of Buzuku should be sought within the boundaries of Kraja, Ljarje and Shestan, west of Shkodër.

Keywords: *Meshari, Gjon Buzuku, Justin Rrota, Eqerem Çabej, Krajë, Ljarje, Shestan, Gjon Nikollë Kazazi, Demiraj.*

*Nji vepër për të cilën kombi shqyptar do të lumnojë e
do të krenohet... âsht me të vërtetë ky monument jetik i
letratyres shqype, që, si vigâ ngrehet madhnueshem,
për me ua diftue nipavet t'ilirvet gjûhën që folën të parët e tyne...
si kje folun në shekullin e ngjitë mbas deke së Skanderbegut.*

J. Rrota, 1938

Viti 1555 shënon një datë të rëndësishme të kulturës sonë kombëtare, botimin e librit të parë në gjuhën shqipe, 463 vjet më parë, “*Mesharin*”, monument i shqipes mesjetare, hartuar nga Gjon Buzuku. Atij i takon merita e veçantë se në rrethana shumë të vështira të historisë së popullit

tonë, duke ndjekur gjurmët e një tradite kulturore, hapi një udhë që do të përfaqësojë një traditë të re të letërsisë shqiptare dhe të shkrimit shqip. Vepra ka vlera të veçanta gjuhësore, letrare dhe historike. Por krahas këtyre, ajo ka rëndësi për historinë e gjuhës së shkruar dhe për alfabetin e saj, pasi është alfabeti i parë i plotë i gjuhës sonë që do të krijonte hapësirë për të shkruar dhe botuar vepra në gjuhën amtare të niveleve të ndryshme. Kjo vepër nuk duhet të jetë shkruar në një terren të virgjër, por mund të jetë një urë vazhdimësie në mes atyre pak gjërave në shqip, por të paargumentuara plotësisht dhe të vetë *“Mesharit”*. Kjo traditë për kohën nuk ka qenë e përparuar, e stabilizuar, e ngulitur, mund të ketë qenë e kufizuar dhe pak e njohur për disa dhe e panjohur për të tjerë, rrjedhojë e vetë kushteve historiko-shoqërore të kohës. Këto rrethana bënë që të lindte nevoja për libra fetarë në gjuhën shqipe dhe t’i drejtoheshin përkthimit të pjesëve të ndryshme fetare, nismë që e mori Gj.Buzuku. *“Puna e Buzukut, shkruan prof. Mahir Domi, për përkthimin e “Mesharit ngjan të ketë pasur lidhje me këto prirje emancipuese europiane, duket e frymëzuar nga synimi për të krijuar një kishë katolike shqiptare me gjuhën shqipe si gjuhë të shërbimeve fetare.”*¹

* * *

Pak histori

Si u zbulua Meshari, kush e zbuloi dhe kur? Afro dy shekuj pas botimit të *“Mesharit”* të Gjon Buzukut dhe 278 apo 275 vjet më parë u zbulua kjo vepër e parë e gjuhës shqipe, një ekzemplar i vetëm deri më sot. Ishte një ditë fatlume ajo e vitit 1740 apo 1743 kur gjakovari Gjon Nikollë Kazazi, arqipeshkëv i Shkupit, i ndodhur në Romë për një vizitë në kolegjin e propagandës Fide, ra në gjurmë të këtij libri dhe i dërgoi një fragment rituali atë Gjergj Guzetës, themeluesit të seminarit të Palermos. Për disa kohë, shkruan Çabej për këtë problem, rektorët e mëpastajmë të këtij seminari, Pal Parrino (1710-1765) dhe Zef Krispi (1781-1859) ishin njohur me këtë dokument të rrallë që kaloi nga dora e atë Gjergj Guzetës te rektorët e mëvonshëm. Pastaj, libri ra prapë në harresë prej afro dy shekujsh. Rizbulimi u bë në vitin 1909, 109 vjet më parë me interesimin e peshkopit arbëresh Imzot Pal Skiroit në bibliotekën e Vatikanit, që fotografoi librin, e transkriptoi dhe e transileteroi, shoqëruar me një studim për gjuhën Buzukut, duke e krahasuar me autorët e tjerë të vjetër dhe e përgatiti për ta botuar. Dëshira e tij nuk u realizua dhe sa që gjallë nuk e pa dritën e botimit, me përjashtim të disa copave biblike nga vepra.²

1 M. Domi, *Rreth disa çështjeve të gjuhës së “Mesharit” të Gj.Buzukut*, në *“Seminari XVII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”*, Tiranë, 1995, f. 459.

2 E. Çabej, *Meshari i Gjon Buzukut (1555)*, I, botim kritik, punuar nga Eqrem Çabej, pjesa e

Lajmin e parë për rigjetjen e veprës, siç shkruajnë studiuesit e veprës së Buzukut, e dha P.Skiroi në gazetën *“Dielli”* që dilte në Boston të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, më 18 mars 1910, si *“përgjigje të një kumtimi të mëparshëm të Faik Konicës në po atë gazetë mbi librin më të vjetër të shkruar në gjuhën shqipe...”*³ Më pas disa fragmente nga *“Meshari”* me komente u botuan te fletorja *“Tomori”* që dilte në Elbasan dhe në fletoren e K. Luarasit.⁴ Kjo është historia e zbulimit të *“Mesharit”*.

* * *

Studiuesi prof. Bardhyl Demiraj në monografinë *“Jeta dhe trashëgimia e Gj.N.Kazazit”*, Shkodër, 2013, diskuton se në cilën kohë u zbulua *“Meshari”* i Gjon Buzukut nga Gj.N.Kazazi. Autori thekson se Kazazi këtë gjetje duhet t’ia ketë bërë të njohur at Gjergj Guxetës në një letër së cilës i bashkëngjijt edhe pjesë të kopjuara nga ky libër.⁵ Demiraj sqaron se kjo letër nuk është tashmë e panjohur për lexuesin, pasi ajo është publikuar nga M.Mandala që në vitin 1996⁶ dhe B.Demiraj e jep edhe në këtë botim⁷ Ribotimi i plotë i së ashtuquajturës *“Kopje”* të kësaj letrë, sipas B.Demirajt, fiton rëndësi të veçantë, pasi në të jepet një informacion sado i thukët si për shkallën e përditësimit të Kazazit me tekstin e *“Mesharit”*, ashtu edhe me copat e tekstit që kopjoi ai dikur me penën e tij.⁸ Autori vazhdon të diskutojë për këtë problem.⁹

Nga kjo letër B. Demiraj ngre pyetjen kur e zbuloi Gj. N. Kazazi *“Mesharin”* e Gj. Buzukut? Fillimisht sqaron se studimet e derisotme pranojnë se viti i zbulimit të parë i përket vitit 1740 dhe autori shënon faktorët që çuan studiuesit në këtë datë.

Duke u mbështetur në letrën e sipërpërmendur të Gj. N. Kazazit, B. Demiraj kundërshton të dhënat e derisotme se zbulimi i *“Mesharit”* i përket

parë, hyrje dhe transliterim, USHT, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë Tiranë, 1968, f. 7.

3 J. Rrota, *Monumenti më i vjetri i gjuhës shqype*, Shkodër, 1938, f.5. Shih më hollësisht edhe B. Demiraj, *Jeta dhe trashëgimia e Gjon P.Nikollë Kazazit*, Shkodër, 2013, f. 109, shën.129.

4 J. Rrota, *Monumenti më i vjetri i gjuhës shqype*, Shkodër, 1938, f. 5.

5 B. Demiraj, *Jeta dhe trashëgimia e Gjon P.Nikollë Kazazit*, Shkodër, 2013, f. 105.

6 Po ai, po aty, f. 105, shën. 123.

7 Po ai, po aty, f. 107; Shih edhe: B.Demiraj, *Viti i zbulimit të “Mesharit” të Gj.Buzukut dhe ndonjë çështje që lidhet me të*, në *“Βιβλος”*, 26, Palermo, 2005, ff. 47-53, (Cit. sipas B.D.).

8 Po ai, po aty, f. 108.

9 Po ai, po aty, f.108. Autori shkruan: *“Kështu leximi i dy paragrafëve të parë të letrës të çon në përfundimin bindës se Kazazi jo vetëm ka zbuluar këtë libër, por e ka lexuar e studiuar atë në detaj, ndërkohë që kopjimi i tij i pasthënies së autorit dhe i një cope teksti të vetë “Mesharit” ngërthen në vetvete përpjekjen e parë të njohur në historinë e filologjisë shqiptare lidhur me riprodhimin diplomatik të një teksti të vjetër shqip.”*

vitit 1740. Kjo letër, sipas autorit, na bind se nuk është viti 1740 i zbulimit të “*Mesharit*”. Ai shpreh mendimin se periudha kohore shkurt-shtator 1743 është periudha më e mundshme e zbulimit të “*Mesharit*” të Gj. Buzukut.¹⁰

Ky ishte një saktësim. Gjithashtu B. Demiraj, duke u mbështetur në literaturë dhe në kërkimet e tij pohon se “*Meshari*” i Gjon Buzukut hapi një dritare të re në historinë e librit të parë shqip, meqë parësinë për zbulimin e tij jemi të detyruar t’ia përcjellim tash me nderim klerikut arbëresh imzot Filoteo Zasit (Philoteo Zassi), ndërsa vetë kohën e këtij zbulimi duhet ta shtyjme më thellë pikërisht në një periudhë, kur Zasi ynë gëzonte në Romë fundin e jetës së tij (1716-1726). “Sigurisht që për këtë dhuratë informative i mbetemi mirënjohës farëmiri Ketë, i cili na la trashëgim një “*Thesar*” që ruan sot e gjithë ditën funksion orientues dhe nxitës në kërkimet e mëtejshme filologjike”.¹¹

Sipas interpretimit dhe argumentet që sjell prof. B.Demiraj, sivjet është 275-vjetori i zbulimit të “*Mesharit*” të Gjon Buzukut nga Gjon N. Kazazi.

* * *

Më 1929, kleriku dhe gjuhëtari Justin Rrota (1889-1964), “*ky studiues i gramatikës dhe i literaturës së vjetër shqiptare*” mori nismën për të fotografuar këtë vepër të parë të gjuhës shqipe.¹² Justin Rrota në shkrimin “*Ma të parat kopje të fotografueme të Buzukut ndë Shqipëni*”, e përshkruan me një pasion të veçantë këtë rrugëtim për të fotografuar “*Mesharin*”. Dëshira e madhe për t’u njohur sa më parë me këtë ekzemplar të vetëm dhe të rrallë, thekson autori, ishte e jashtëzakonshme. Kalova momente demoralizimi, por, duke pyetur, m’u hap porta. “*Bana si bana, shkruan Rrota, dhe hyna edhe unë në bibliotekë. Mirë se hyna, por ku do t’ua nisshem kërkesavet, që përposë emnit t’auktorit dhe të titullit të trilluem të Mesharit, nuk kishem kurrnji shenjim tjetër. Duhet me u gjetë mbrendë nd’atë pyll të dendun librash dhe dokumentash, sikurse gjindeshem unë atë ditë për ma të parën herë ndë jeten teme për të pasun iden çka asht ajo biblioteka*”.¹³

Ditët kalonin dhe ishte një moment gëzimi i paparë kur më njoftuan dhe ma dorëzuan librin e dëshiruëm. “*Sa s’qava prej gëzimit, vazhdon autori, e mora ngrykë Buzukun e dashun, e putha me nderim dhe u vuna*

10 Po ai, po aty, f. 112.

11 B. Demiraj, *Një dorëshkrim ritual në gjuhën tonë që duhet kërkuar*, “Hylli i Dritës”, 2007, nr.1, f. 34; Po ai, *Jeta dhe trashëgimia e Gj. N. Kazazit*, f. 112.

12 E. Çabej, vep. e cit. ff. 7-8.

13 J. Rrota, *Ma të parat kopje të fotografueme të Buzukut ndë Shqipëni*, në “*Për historinë e alfabetit shqyp dhe studime të tjera gjuhësore*”, botime françeskanë, Shkodër, 2005, ff. 57-60.

mbë tryezën e madhe të studiuesave."¹⁴ Mbas disa ditësh fotografisti me një lidhje elegante më dorëzoi tre blejt e Buzukut. E mbyll shkrimin Rrota me këto fjalë:

*Sa i vogël edhe unë!...Kënaqeshem tue i këqyrë ata tre blej. Si të kishem bâ një punë të madhe!*¹⁵

* * *

2012. Me rastin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, në marrëveshje me Bibliotekën e Vatikanit u arrit që origjinali i veprës "*Meshari*" të ekspozohej në Shqipëri, në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë nga data 12 nëntor 2012 deri më datë 28 nëntor 2012. Edhe për ne si shikues emocioni ishte i madh, pasi jo vetëm kishim folur sa e saherë me studentët për këtë vepër të parë të shkruar në gjuhën shqipe, por edhe kishim botuar ndonjë shkrim sado modest për këtë vepër. Me kolegë dhe familjarisht hymë në sallën e Bibliotekës Kombëtare në Tiranë ku "*Meshari*" ishte vendosur në një inkubator, ekspozuar midis xhamave, ndonëse ruajtësit e këtij monumenti kaq të rëndësishëm për shkrimin e shqipes, bënë detyrën e tyre. Përkrah origjinalit, por jo së bashku më të ishte ekspozuar edhe riprodhimi fotografik i kësaj vepre, i realizuar nga Justin Rrota. Ndjejmë një kënaqësi të veçantë, por kureshtja e shikuesve ishte e madhe.

Takuam në këtë rast edhe nxënësit e një mature të Tiranës. Duke qenë se ishin ekspozuar edhe veprat e pasardhësve të Buzukut, të pranishmit e kthyen për afro dy orë një auditor diskutimi, vlerësimi dhe të një ndjenje të veçantë atdhetarie. Por vepra pas dy muajsh mori rrugën e kthimit për t'u vendosur në atë vend nga kishte ardhur si një dokument që ruhej prej afro pesë shekujsh.

* * *

2014. Një vizitë historike u konsiderua ardhja e Papa Françeskut në Shqipëri, më 21 shtator. Në vizitën që bëri në Presidencë, Presidentit Republikës z. Bujar Nishani, pas fjalës përshëndetëse i dhuroi Papa Françeskut një portret të gdhendur në argjend të Giovanni Francesco Albanit, Papa Clemente XI me origjinë shqiptare me mbishkrimin "*Shtëpia e shqiptarit është e Zotit dhe e mikut.*" Pastaj Papa Françesko i dorëzoi Presidentit të Republikës, z.Bujar Nishani një kopje të dixhitalizuar të "*Mesharit*" të Gjon Buzukut.

* * *

14 Po ai, po aty, f. 58.

15 Po ai, po aty, f. 60.

2015. Më 23 dhjetor 2015 Presidenti i Republikës së Shqipërisë, zoti Bujar Nishani bëri një vizitë në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë në kuadrin e 95-vjetorit të themelimit të saj dhe i dorëzoi këtij institucioni kopjen e dëxhitalizuar të “Mesharit” të Buzukut, dhuratë e Papa Françeskut, gjatë vizitës së tij në Presidencë, më 21 shtator 2014.

Kështu Shqipëria sot ka kopjet e fotografuara të J. Rrotës, kopjen e dixhitailizuar, si dhe riprodhimin e E. Çabejt dhe të N. Resulit.

* * *

Ende sot ka probleme të diskutueshme për autorin dhe veprën e tij. Siç dihet, vepra që u zbulua, nuk qe e plotë. Është një kopje e mangët, “*i shkyem e i zhyem në shum vende*” (Rrota). Nga 220 faqe të kësaj kopjeje i mungojnë 16 faqet e para, mungon kështu edhe titulli i librit, por ruhet pasthënia. Titullin “*Meshari*” ia vuri Gj. N. Kazazi kur e zbuloi dhe kështu vazhdoi deri në ditët e sotme. Megjithatë pasthënia na informon për disa të dhëna për autorin e ndonjë të dhënë tjetër. Kështu mësojmë se dom Gjon Buzuku është i biri i Bdek Buzukut dhe veprën e filloi, më 20 mars 1554 dhe i dha fund, më 5 kallnuer 1555.

Nuk janë zgjidhur kënaqshëm disa çështje, si vendlindja e Buzukut, kur lindi dhe kur vdiq, prej ç’krahine ishte autori ynë, arsimimi i tij, në ç’vend u shtyp “*Meshari*”, çfarë të folmeje përfaqëson vepra e tij etj.

Ndër studiuesit e parë përmendim Justin Rrotën. Ai pohon se Gjon Buzuku ishte një prift shqiptar e famullitar në një fshat jo shumë larg prej vendit ku u shtyp libri në Shqipëri, më shumë në Obot, por disa vjet më vonë, më 1938 me ribotimin e veprës “*Monumenti ma i vjetri i vjetri i gjuhës shqype*”, Shkodër, 1938, ai ndryshoi mendim duke theksuar se “*mbas gjitha gjasash libri i Buzukut u botue në shtypshkronjën e Venedikut*.”¹⁶ Por Rrota nuk kënaqet me ato që kishte arritur. Më pas ai pohon se Buzuku ka qenë një prift katolik shqiptar, një gegë autentik. Rrota bën një hap përpara, duke argumentuar bindshëm se “*Gjon Buzuku qe një malsuer i Krajës, lokalitet i Perëndimit të Liqenit të Shkodrës*”¹⁷, duke hedhur poshtë mendimin se Buzuku mund të ketë lindur në Gegërinë verilindore. Rrota insiston se duke u mbështetur në argumente gjuhësore se vendlindja e Buzukut “*do të kërkohet ndër krahinat e naltëpërmenduna të Krajës dhe të Shestanit*”.¹⁸ Autorë të tjerë kanë edhe ata mendimet e tyre. Ja ç’mendojnë disa për vendin e botimit. Sipas Rrotës, Norbert Jokli jep Shkodrën, Filip Fishta Durrësin, J.Tomiç Napolin dhe së mbramit puna që kishte gjasë se u shtyp në Venedik u përkrah nga M. Roku, K. Taliavini e E. Çabej. Për këtë pohon: “

16 J. Rrota, *Monumenti ma i vjetri i gjuhës shqype*, Shkodër, 1938, f. 9.

17 Po ai, *Hulumtime dhe shenjime mbi Gjon Buzukun*, BSHSH, 1956, nr. 3, f. 173.

18 Po ai, po aty, f. 175.

Na vetë edhe do të kishim pranue këtë opinionin e fundit po të mujshim me i kapërcye do vështirsi për menden tonë të papajtueshme.”¹⁹

* * *

Po cili ishte mendimi i prof. E.Çabejt për këto çështje të diskutueshme? Prof. Çabej në vitin 1968 realizoi botimin kritik në dy vëllime të kësaj vepre, shoqëruar me një studim të gjatë, ku autori jep shpjegime për shumë probleme të diskutueshme, paraqet tekstin e riprodhuar me fototipi, transliterim dhe transkriptim fonetik.²⁰ *“Vlera e këtij ribotimi, thekson Sh. Demiraj, është e pallogaritshme, sepse në këtë mënyrë breza të shumtë gjuhëtarësh brenda dhe jashtë Shqipërisë kanë në dorë një botim shkencor...të pajisur me shënime sqaruese aq të nevojshme dhe të prira nga një studim i gjatë hyrës dhe i shumanshëm.”*²¹ Duke u mbështetur në disa indice gjuhësore, sipas Çabejt, ata dëshmojnë se *“ai është bir i malësisë së Krajës, Ljarjes e Shestanit në jugperëndim të liqenit të Shkodrës, një famullitar i dalë prej dioqezës së Tivarit a mbase Ulqinit.”*²² Megjithatë nuk i jep zgjidhje përfundimtare kësaj alternative, por vëren se vendi i banimit të autorit e i hartimit të librit dhe vendi i shtypit të këtij mund të kenë qenë të ndryshme.²³ Çabej thekson se gjuha e veprës është e ngritur në një shkallë mbidialektore, me elemente të Shqipërisë veriore, por pranon autori se ka disa tipare që flasin për një komponente verilindore dhe lindore në gjuhë, të cilat paraqitën më shpesh përzier me tiparet veriperëndimore që Çabej përpiket ta vërtetojë me shëmbuj nga vepra. Autori nuk e përjashton mundësinë e lidhjes me zonën verilindore. Për Buzukun mendon se në vendin ku lindi dhe u rrit ky shkrimtar ka pasur një dyndje popullsie të trevave verilindore. Kështu mund të kemi të bëjmë, përsëri sipas Çabej, me një burim verilindor të fisit të Buzukut tonë ose me një shpërngulje më të madhe e shumë më të moçme.²⁴

* * *

Vepra ka vlera të veçanta gjuhësore. Një ndër problemet më të rëndësishme që u ndesh Buzuku, që ai i grafisë. Alfabeti i tij u mbështet në alfabetin latin që pati vazhdimësi deri në Kongresin e Manastirit (1908). Ai

19 Po ai, po aty, f. 183.

20 E. Çabej, *Meshari i Gjon Buzukut (1555)*, I, botim kritik, punuar nga Eqrem Çabej, pjesa e parë, hyrje dhe transliterim, USHT, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1968.

21 Sh. Demiraj, *Eqrem Çabej, një jetë kushtuar shkencës*, Tiranë, 1990, f. 116.

22 E. Çabej, vep. e cit., f. 22.

23 Po ai, po aty, f. 17.

24 Po ai, po aty, f. 22.

u bë pikë mbështetjeje dhe referimi për pasardhësit. Me të fillon historia e shkrimit shqip. Ishte e tipit gjysmë gotik. Autori përdor edhe pesë shkronja të veçanta që u gjetën në shtypshkronjën, e cila do merrej me botimin e kësaj vepre, sesa i dëshirave vetjake të autorit. Sipas J.Rrotës “*autorët e vjetër as kishin nge, as kishin gatimin e duhun.*” për t’u marrë me një problem të tillë.

Interes ka edhe leksiku i përdorur në vepër, duke ditur se ky është autori i parë i letërsisë shqiptare. Sipas një studiuesi në 188 faqe të librit fjalori përmban rreth 1500 leksema.²⁵ Prof. Kolë Ashta që është marrë me leksikun e autorëve të vjetër, duke nisur nga Buzuku saktëson se leksiku i plotë i nxjerrë nga vepra e Buzukut (1555), ka 2127 fjalë.

Për vlerat e “*Mesharit*” në disa rrafshe janë botuar deri më sot një numër i konsiderueshëm shkrimesh²⁶, prandaj nuk po ndalemi në këtë fushë.

* * *

Gjon Buzuku, edhe pas afro pesë shekujsh mbetet një autor me merita të veçanta, që na dha, me sa dimë deri më sot, librin e parë në gjuhën shqipe me vlera gjuhësore, letrare dhe historike, alfabetin e parë dhe të plotë të gjuhës sonë, jo një alfabet ideal dhe i përkryer, por për kohën kur u zbatua pati rëndësi dhe rrezatim të veçantë, duke çelur udhën e historisë së shkrimit shqip.

25 Agjencioni Floripress, *Gjon Buzuku dhe libri i parë shqip* (1555), 27 qershor 2012, (marrë nga interneti).

26 Shih: J. Kastrati, *Studimet albanistike për Buzukun*, në “Seminari XVII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Tiranë, 1995, ff. 421-425.